



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL<sup>1</sup>

(I përmbledhur)

Tiranë, më 18.03.2019, ora 13.00

**Drejton mbledhjen -**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

*1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

#### **Marrin pjesë<sup>2</sup> :**

- |                          |                        |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani        | (kryetar)              |
| 2. Vitore Tusha          | (zëvendës kryetare)    |
| 3. Arta Marku            | (anëtare)              |
| 4. Fatri Islamaj         | (anëtar)               |
| 5. Margarita Buhali      | (anëtare)              |
| 6. Eriol Roshi           | (anëtar)               |
| 7. Medi Bici             | (anëtar zëvendësues)   |
| 8. Gurali Brahimllari    | (anëtar zëvendësues)   |
| 9. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

<sup>2</sup> Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, gjithashtu dhe komisioreja .

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :**

1. Agnes Bernard, drejtuese e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, ekspert i EURALIUS

**HAPET MBLEDHJA**

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

*Ardian Dvorani* lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

*Anëtarët e Këshillit* miratojnë rendin e ditës së programuar.

*Këshilli vijon mbledhjen* sipas rendit të ditës me *Diskutimin dhe miratimin e Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

*Ardian Dvorani*, si relator i projektaktit, bën një parashtrim hyrës për diskutimin, duke e orientuar atë në fillim tek dy Aneksat e projektaktit. Pas parashtrimit hyrës, meqenëse për hartimin e projektaktit bashkëpunohet me Euralius, si edhe pasi merr miratimin e anëtarëve, i kërkon *Agnes Bernhard* të parashtrorë mendimet e tyre mbi këtë projektakt.

*Agnes Bernhard* (përkthen përkthyesja), parashtron se është bërë përpjekje për të hartuar skema të cilat të jenë sa më pranë kriterëve të parashikuara nga ligji dhe ti organizojmë ato përkatësisht njëra për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe tjetra për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Megjithëse kanë disa tipare dhe përshkrime specifike, ato kanë ngjashmëri. Secila

prej tabelave shoqërohet me një relacion ku shpjegohet në fakt situata. Në skemën për Gjykatën Kushtetuese për bazën ligjore jemi mbështetur në Kushtetutë, në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe ligjin për qeverisjen e drejtësisë. Në kolonën e parë gjenden të gjithë nenet përkatës bazuar në ligjet e sipërcituara për gjykatën kushtetuese. Gjatë shqyrtimit të bazës ligjore vërehet se disa nga kriteret dhe parashikimet ishin pak a shumë të ngjashme. Për të shmangur mbivendosjen apo ripërsëritjen e tyre, i kemi grupuar në kategoritë përkatëse. Mbështetur në bazën ligjore, i kemi ndarë në tre kategori: meritat profesionale, morale dhe aftësitë organizativ e menaxhuese. Secilin kriter e kemi zbërthyer më tej, duke përcaktuar elementet përkatës më të detajuar, shoqëruar edhe me indikator ose tregues. Më pas jemi përpjekur të nxjerrim disa shembuj të burimeve, dokumenteve për vlerësimin e këtyre treguesve, si pika reference për këshillin mbështetur në këto kriteret. Krahas pikëve maksimale, jo në të gjitha kategoritë është e zbatuar vlerësimi në pikë për secilin nga këto grupkriteret. Kemi ecur me parimin që të mos vendosim rend hierarkik midis kriterëve, të marra nga njeri ligj apo nga ligji tjetër. Megjithatë disa kriteret janë më relevante, më të lidhura për pozicione të caktuara, krahasuar me të tjerat. Për shembull, për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese kriteret profesionale dhe morale janë të parat dhe më pak kanë rëndësia kriteret mbi aftësitë menaxheriale, drejtuese. Ndërsa tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka një peshë më të madhe për kriteret menaxhuese.

Sipas fushave të interesit apo të kompetencave, jemi përpjekur të ndërtojmë profilet përkatëse, p.sh. për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve dhe atyre nga radhët e jogjyqtarëve. Për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese kemi menduar të përcaktojmë pikëzime të posaçëm për njohjen e të drejtës kushtetuese. Kur vjen puna tek vlerësimi dhe pikëzimi i rezultateve profesionale plotësuese, mbahet parasysh që do të ishte me vend që në Gjykatën Kushtetuese të kemi gjyqtar apo profesionist nga fusha të ndryshme të së drejtës. Aty shqyrtohen çështje që shpesh janë komplekse të vështira që nuk vijnë vetëm nga fusha të caktuara të së drejtës, por nga fusha të ndryshme. Prandaj kërkohet ekspertizë për secilin rast. Për sa i përket kriterëve të tjera që kanë të bëjnë me arsimin, titujt që mbajnë, trajnimet profesionale, angazhimet në aktivitetet e tjera ligjore, angazhime të tjera në shoqërinë civile, në tërësinë e tyre i kemi vendosur një pikëzim pak më të vogël në pikë. Këto janë pak të vështira për tu matur, por edhe nga pesha që ato zënë në profilin e gjyqtarit përkatës, gjykojmë mos të kenë rëndësi aq të madhe sa mund të ketë profili i tij në të drejtën kushtetuese.

Ndërsa trajnimet nuk duhen parë ngurtazi vetëm në aspektin e sasisë por duhen parë efektet e trajnimeve në veprimtarinë profesionale. Prandaj është gjykuar që të ketë një pikëzim më të ulët thjesht për trajnimet e zhvilluara, duke i dhënë më shumë rëndësi rezultateve

profesionale, pra se si kanë ndikuar këto trajnime në profilin profesional. Prandaj rezultatet profesionale kanë një peshë shumë të madhe dhe janë shumë të rëndësishme në këtë skemë vlerësuese.

Këshilli do të përballet me vështirësinë e të vlerësuarit të kategorive të ndryshme të kandidatëve me gjyqtar, prokuror, avokat, noter, nëpunës të administratës. Parimore është që asnjëri nuk duhet të ketë një pikënisje konstante. Secili kandidat duhet të dorëzojë produktet më të mira intelektuale të tij dhe këto do të variojnë, nuk është se janë standarde, sipas profileve të tyre. P.sh. një gjyqtar mund të dorëzojë vendime gjyqësore e jo domosdosmërisht edhe publikime shkencore. Një profesor mund të dorëzojë publikimet e veta më të mira. Një avokat mund të dorëzojë rekursat, paditë që ka mbrojtur, përfaqësuar. Vlerësimi i tyre nga KED bëhet për origjinalitetin, aspektin analitik, saktësinë, argumentimin dhe një kontroll për plagjaturën. Për të thjeshtëzuar punën e Këshillit në raste të tilla, mund të angazhohet edhe një ekspert jo thjesht për të bërë vlerësimin por me një funksionin facilitues e lehtësues për punën e Këshillit, për të pasur një ekspertizë më të profesionalizuar. Më pas Këshilli mund të vijojë me pikëzimin, mbështetur edhe në mendimin e ekspertit.

Grupi i dytë i kriterëve janë për meritat morale të cilat janë shumë të rëndësishme por edhe akoma më të vështira për tu matur. P.sh. si mund të matet reputacioni i kandidatit, cilat burime janë për tu besuar dhe për tu marrë për bazë, pa u ndikuar edhe nga thashethemet, burimet e ndryshme e të pa vërtetueshme. Po kështu edhe elementë të tillë si ndërgjishmëria, përpikëmeria, drejtësia, dinjiteti. Megjithatë dikush që ka probleme me këto kriterë as nuk duhet të ketë mundësinë të jenë në renditjen më të lartë.

Për rrjedhojë, duke patur parasysh rëndësinë që kanë këto dy kategori të meritave, profesionale dhe morale është menduar që të klasifikohen dhe renditen vetëm ata kandidatë që do të arrijnë 60 % të pikëzimit të vlerësimit për secilin nga seksionet përkatëse të këtyre kategorive. P.sh tek kategoria e meritave morale, ai person që nuk i ka këto merita duhet të mos arrijë të marrë 60 % të pikëve. Kandidatët që kanë kaluar me sukses fazën e verifikimit, pra edhe pjesën e intergritetit dhe të pasurisë, nuk përjashtohet rasti që të kemi dyshimet tona se edhe klasifikimi i tyre mund të ketë qenë pak i dyshimtë, i dyzuar. Prandaj edhe vlerësimet tek kategoria e meritave morale janë programuar në format të tillë që nëqoftëse kandidati nuk arrin 60 % ai nuk është i përshtatshëm për tu përzgjedhur si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Mund të shikoni avantazhet dhe disavantazhet e kësaj mënyre vlerësimi.

Lidhur me kriteret e vlerësimit për meritat organizative, të lidhshmit, të drejtimit dhe menaxheriale drejtuese, duke qene se nuk janë shumë të rëndësishëm për profilin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, janë lënë të fundit, me më pak pikë dhe këtu nuk kemi parashikuar

pragun e përshtatshmërisë prej 60 % . Ndërsa kur vjen puna tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, funksioni i tij është funksion shumë drejtues dhe menaxherial. Prandaj merr më shumë rëndësi, ka më shumë pikë dhe këtu rikthehet pragu i përshtatshmërisë së përzgjedhjes prej 60 %.

Pra, kandidatët të cilët, në njërin apo tjetrin kriter nuk arrijnë 60 % të pikëve të shikohen si kandidat i papërshtatshëm, i cili është një term që preferohet e përdoret edhe nga Komisioni i Venezas. Është rasti i atyre kandidatëve të cilët i përmbushin të gjitha kriteret e kandidimit, kalojnë të gjitha fazat kualifikuese, megjithatë konsiderohen si jo të përshtatshëm për pozicionin. Këtu mund të arrijmë në sfidën ose pikëpyetjen që kemi për rastin e 3 kandidateve, të cilët janë të tre të kualifikuar dhe të rankuar lart, por konstatojmë që njeri nuk është i përshtatshëm për pozicionin. Kur ia adresojmë listën e këtyre 3 kandidatëve organit emërues, ne i përcaktojmë dhe japim argumentat përkatës për secilin kandidat duke i treguar p.sh. që kandidati i tretë është i papërshtatshëm dhe më pas mbetet në të drejtën e organit emërues që ta emërojë ose jo këtë kandidat. Megjithatë, ky është një propozim dhe i hapur për diskutim.

*Anëtarët e Këshillit*, vijojnë me diskutimin e përgjithshëm dhe në parim të projektaktit, veçanërisht për çështjet kryesore të parashtruara për diskutim lidhur me për anekset e kriterëve dhe kategorive të vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidaturave, strukturën e projektit, grupimin e kriterëve të vlerësimit në tre kategori, peshën specifike të këtyre kriterëve sipas parashikimeve të Kushtetutës, ligjit të posaçëm dhe rregullimeve ligjore të përgjithshme, për mundësinë e angazhimit të një eksperti për vlerësimin dhe pikëzimin e meritave profesionale të kandidatëve nga një ekspert i jashtëm etj.

*Erinda Ballanca*, pas diskutimeve ndërmjet anëtarëve të Këshillit, kërkon fjalën dhe parashtron se të procedurat për emërimet kanë dy elementë. Njëri element është plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore që janë kriteret kualifikues. Pjesa tjetër përbëhet nga mënyra se si krijohet bindja e brendshme e secilit prej anëtarëve të Këshillit për të vlerësuar dhe renditur X Apo Y kandidat. Këto janë të tëra mjete apo kritere të cilat përcaktohen në ligj dhe që përbëjnë metodologjinë që secili prej anëtarëve të Këshillit do të duhet të vërë në jetë për të nxjerrë produktin përfundimtar e që është edhe qëllimi i Këshillit, konkretisht renditjen e kandidateve. Duke qenë se nga eksperiencia personale kam kaluar nëpër një proces të ngjashëm më shumë se njëherë, jo si kandidate por si vlerësuese, mendoj se ka shumë rëndësi që kriteret jo vetëm të jenë të qarta por edhe të lejojnë diskrecion. Ky lloj diskrecioni nuk duhet parë me frikë për sa kohë që mendoj se ky Këshill i ka kualitetet për të marrë vendime të arsyetuara mirë. Në këtë pikë shikojmë një problem që mund të ketë karakter tërësisht teknik. Të mendojmë për rastin që e projektin e vlerësimit e përcakton relatori, e sjell si projekt dhe nuk

biem dakord me atë vlerësim. Si do të procedohet me vlerësimin për atë kriter? Për të caktuar pikët do të ketë shumicë? Duhet që qartësisht të përcaktohet një vlerësim. Këto pikë duhet të jenë një shumatore e pikëve të secilit prej anëtarëve, e cila do të ndryshojë nëse numri i anëtarëve do jetë ose jo i plotë. Nuk mund ti themi relatorit të vijë me një rënditje.

Ndërkohë nga shikimi i kriterëve i jepet një vlerë e rëndësishme mendimit të ekspertit. Për hir të së vërtetës, krijon problem në vlerësimin e kriterit profesional kur opinioni i ekspertit nuk është në përputhje me gjykimin, në kuptimin e ligjit, për të cilën është zgjedhur ky Këshill. Pra nëse ky Këshill nuk është i aftë as të përcaktojë vlerësimin profesional, flasim si juristë, si njohës së të drejtës, jo për kriterë specifike që mund të jenë gjuhët e huaja, besoj se nuk ka asnjë arsye për të cilën të rrimë të mbledhur. Pra gjykoj që ky Këshill ka qartësisht të gjithë kompetencën juridike për të bërë vlerësimin e kandidatit për kriterin profesional. Nga ana tjetër, prozimi është për të futur një ekspert, i cili në fakt nuk i njeh kandidatët që mund të duken shumë mirë në letër, por mund të mos jenë ashtu në jetën e përditshme. Por ky Këshill do që të njohë kandidatët për performancën e tyre të punës ndër vite apo për reputacionin që ndërtohet në mënyrë të vazhdueshme. Nëse propozohet që eksperti të ketë jetuar jashtë shtetit, njeh gjuhën shqipe, por nga ana tjetër të jetojë jashtë shtetit, nuk e di se sa e vlefshme do të jetë një gjë e tillë sepse nuk mundet që eksperti të bëjë një vlerësim me pikët më të mëdhaja të mundshme, pra me 20 pikë dhe kjo të bëhet vetëm për dy tre elemente të produktit intelektual. Nga ana tjetër, do të krijohet një problem edhe për faktin se vendimet e gjyqtarëve, që mund të jenë gjyqtarë apeli dhe të Gjykatës së Lartë, nuk janë vetëm produkt i tyre por i kolegjit që ka gjykuar. P.sh. në Gjykatën e Lartë, pavarësisht se vendimin mund ta bëjë relatori ai është produkt i të gjithëve. Po kështu, paraqitja e dokumenteve për vlerësim mund të jenë edhe punime shkencore apo mbrojtje etj. që kanë secila karakter specifik. Pra nuk mund të ketë një ekspert që të ketë njohuri dhe të ketë informacion për të gjitha e të jetë ekspert për vlerësim edhe për një vendim gjyqësor, edhe për mbrojtje avokati, edhe për doktoratura apo punime shkencore. Prandaj, mendoj që përfshirja e një eksperti vetëm do ta vështirësonte edhe më tepër punën e këtij Këshilli. Së dyti nuk do të kontribuonte në ndonjë rezultat më të mirë në renditjen e kandidaturave.

Problemi kryesor do të ngelet ajo që edhe znj. Bernhard e paraqiti se si do bëhet vlerësimi midis profesionistëve me background të ndryshëm. Pra nuk mund të jenë të njëjtat kriterë. Ky është i vetmi organ i sistemit të drejtësisë ku janë të lejuar të vijnë edhe juristë të tjerë përveç gjyqtarëve. Të jesh një avokat i sukseshëm besoj se është një kontribut i cili duhet ti jepet dhe duhet ta ketë Gjykata Kushtetuese dhe në këtë kuadër është i vetmi organ ku ka një lloj vlere edhe performanca e tyre në jetën profesionale, në dallim nga Gjykata e Lartë e cila ka

vënë kriterin e doktoraturës si kriter kualifikues në mënyrë të gabuar në gjykimin tim. Si do të jetë kriteri për këta avokatë, për dokumentet që duhet ti vlerësohen, në mungesë të një vlerësimi eprori kush do ti vlerësojë avokatët. Apo për një pedagog, cili do jetë vlerësimi i pedagogut për të kuptuar se sa janë profesional.

Nga ana tjetër një pikëpyetje është edhe diskutimi mbi titujt shkencore dhe ose doktoraturën. Ligji ka përcaktuar tituj shkencore dhe tituj shkencore nuk është doktoratura. Ligji për Arsimin e Lartë përcakton kush janë tituj akademik dhe kush janë titujt shkencorë. Ndërkohë në kriteret kemi përcaktuar doktoraturën si kriter vlerësimi. Sa i përket çështjes së mesatares është pak diferenca në vlerësim ndërmjet notës 8 deri tek 10 vetëm me një pikë.

Për sa i përket çështjes së peshës, ajo që shikoj për hir të së vërtetës këtu tek kriteret organizative dhe menaxheriale është se kane këto pikë që janë këtu, por nuk kanë treguesit dhe burimet e vlerësimit përvec faktit që mund të jenë pozicionet drejtuese apo pozicionet menaxheriale që mund të kenë pasur. Gjithë pjesa tjetër tek burimet nuk ka të bëjë fare me këto dy kriteret. Kanë të bëjnë me elementë të paraqitjes në publik, që kur të dëgjohet që është duke folur të kuptohet që është një gjyqtar kushtetues. Në fakt ka një peshë të caktuar edhe paraqitja publike e tyre. Prandaj është rëndësishme të merren në intervistë, është edhe cv, certifikatat, fjalimet publike që janë bërë.

Ndërkohë që nuk besoj që reputacioni duhet të ketë 4 pikë sepse është shumë i rëndësishëm. Pavarësisht se është kriter shumë i diskutueshëm për tu matur e ka probleme për tu matur. Por, gjithsesi, duhet që të jetë një nga elementët që duhet të ketë një vlerë më të madhe. Pra nuk mund të ketë më pak se 5% të ose 7% të të gjithë pikëve.

Mendoj se, për sa kohë që për vlerësimin nuk duket që ka edhe mjet ankimi, ky është i vetmi dokument që po përgatitet nga Këshilli, i cili do shërbejë si bazë për të vlerësuar punën e Këshillit. Duke i vendosur këto kriteret në të mirë a në të keq do të bëhet edhe vlerësimi i punës ndaj mendoj se do të duhet me vërtetë me shumë diskutim sic dhe u tha me të drejtë edhe nga të tërë anëtarët. Anëtarët sigurisht kanë peshën më të madhe me të rëndësishme sepse ato kanë të drejtën e votës për ti menduar më gjatë dhe për ti parë problematikat që mundet të lindin. Ajo që unë do të bëja vetë, do të merrja një individ ideal. Për shkak të detyrës, në më shumë se në një rast e kam bërë për anëtarët nga Avokacia per KLGJ për KLP dhe për anëtarët nga shoqeria civile. Ajo që të sjell pikëzimi nëpër individë të caktuar është vërtet problematike e duket e parapërcaktuar. Prandaj duhet të mendojmë e të bëjmë një rast praktik sepse vetëm në momentin që ka një rast praktik arrin ta kuptosh se cilët mund të jenë problematikat që mundet të lindin për ta arritur në atë vlerësim që duhet të jetë një vlerësim i drejtë i kandidatëve, një vlerësim i cili nuk duhet të paracaktojë asnjë emër dhe të parapreferojë siç e tha me të drejtë

dhe znj. Agnes, ndonjë grup të caktuar që përfaqëson grupin e juristëve apo në ndonjë grup tjetër.

**Bledar Dervishaj**, kërkon fjalën dhe parashtrohet se ky Këshill ka hyrë në fazën më të rëndësishme, në thelbin e punës së tij. Do të miratojë rregullat për renditjen, për vlerësimin e kandidatëve. Gjëja më e rëndësishme e Këshillit deri me sot është se janë miratuar tre aktet e organizimit, të shortimit dhe të kualifikimit të kandidatëve, lejimit apo ndalimit të kandidimit. Sot po hyjmë në detaje më të holla, ku kandidatët për Gjykatë Kushtetuese dhe ILD do të vlerësohen dhe këshilli do të duhet ta miratojë këtë. Kjo duket edhe nga koha që të gjithë anëtarët e Këshillit i kërkuan anëtarëve të tjerë për tu njohur më në detaje qoftë mbi vetë vendimin apo edhe për tabelat shoqëruese të pikëzimit për çdo kriter. Unë këtë kërkesë të Këshillit e mbështes, sinqerisht. Baza ligjore mbi të cilën duhet të operojmë për miratimin e këtij akti janë kryesisht tre nene që burojnë nga Kushtetuta, neni 7/a i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe tek neni 240 i ligjit nr.115/2016 dhe për këtë duhet një kujdes i madh në miratimin e këtij projektvendimi. Po ti shikosh këto dispozita diku nuk harmonizohen me njëra tjetrën. Ndërkohë që e gjithë logjika ecën me një renditje për çdo pozicion. Prandaj pikëzimi është tmerrësisht i nevojshëm. Kriteret nuk kemi pasur kohë ti shikojmë, por kur të vijë radha në mbledhjen e radhës, mbështes mendimin e kryetarit që përcaktimet e kriterëve të vijnë sipas hierarkisë së vetë normës, pra Kushtetutë, ligj specifik siç është Ligji për Gjykatën Kushtetuese plus Ligji nr. 115. Me cilësinë e përfaqësuesit të një prej organeve të emërteses do të kërkoja shumë vëmendje. I kam lexuar një pjesë të tyre dhe nuk shpreh shpreh dakortësinë për një pjesë të këtyre kriterëve, peshës që u është dhënë dhe do të sugjeroja Këshillit që ti shqyrtonte më me detaje gjithë keto kritere, peshën e secilit prej tyre. Ky akt do të bëjë të mundur vlerësimin e kandidateve që janë juristë, jurisë në administratë, prodhimtarinë e së cilës nuk e kanë ndoshta asnjëherë vendimmarrëse, por si juristë të lartë të administratës, organizatorë apo drejtues, juristë që kanë punuar avokat dhe një rekurs apo një ankim që ato kanë paraqitur në mënyrën më të mirë të mundshme të tyre nuk parashikon aftësi të lartë profesionale dhe mund të mos merren fare me gjyqe. Ose janë juristë që mund të kenë punuar në OJF apo në organizata ndërkombëtare jashtë vendi. Ndërkohë mund të kemi dhe gjyqtarë të cilët nuk e kanë kaluar procesin e vetingut që i përfshin të tre këto kritere që janë këtu edhe gjyqtarë që e kanë kaluar. Prandaj kërkoj një maturi apo qetësi më të thellë ose më të madhe në këtë aspekt të rëndësishëm. Sa i takon ekspertit, mendoj që në këtë proces eksperti mund të thirret nga Këshilli, por për gjerat apo për natyrën e vlerësimit që Këshilli nuk mundet ta bëjë dhe duhet të jenë raste përjashtimore. Edhe diçka për vetë vendimin, të më ndjejë znj. Agnes, besoj nuk më



mërzitet se nga ana e teknikës legislative projekti lë shumë për të dëshiruar. Ky vendim duhet shkundur mirë, kur ti vijë radha e shqyrtimit nga ana e teknikes legislative.

*Anëtarët e Këshillit*, pas një diskutimi tjetër të shkurtër për këtë projektvendim, vendosin që në mbledhjen e ardhshme të vijoje diskutimi mbi një material më të përpunuar në reflektim edhe të mendimeve të dhëna në këtë mbledhje.

*Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani*, pasi merr mendimin e anëtarëve, përcakton zhvillimin e mbledhjes së ardhshme me të njëjtin rend ditë në datën 21.03.2019, ora 14.00.

### **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 15.30**

#### **Sekretare**

**Dorina Dulaj**  
**Ermelinda Kadiu**  
**Redjona Myrtja**

#### **Kryetari**

**Ardian Dvorani**

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.